

## Vendim nr. 255 datë 01.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Ilir Toska, Anëtar

në datën 01.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 33 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** AQIF ÇELA, përfaqësuar nga avokate Marjana Velçani, e caktuar për ofrimin e ndihmës juridike dytësore.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. (82-2016-1129) 742, datë 27.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës; nr. 553, datë 23.11.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-2245, datë 02.06.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i vendimit nr. 197, datë 29.01.2016 të Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Elbasan (sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan), si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 17, 18, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës

**Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi Aqif Çela ka pretenduar se për tokën bujqësore në pronësi të tij është regjistruar në mënyrë të paligjshme akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP) nr. 16, datë 10.02.1992 në emër të shtetasit S.J. Për këtë shkak, kërkuesi i është drejtuar Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (*KVVTP*) pranë Prefektit të Qarkut Elbasan, me kërkesë për deklarimin e pavlefshmërisë së këtij akti. Me vendimin nr. 197, datë 29.01.2016, ky organ, bazuar në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar (*ligji nr. 9948/2008*), ka vendosur pavlefshmërinë dhe shfuqizimin e pjeshëm të AMTP-së nr. 16/1992 në emër të atij shtetasi dhe kalimin e pasurive në pronësi të shtetit. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, në datën 15.02.2016 kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e tij dhe kalimin e këtyre pasurive në pronësi të tij.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. (82-2016-1129) 742, datë 27.07.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, si të pambështetur në prova dhe në ligj. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 553, datë 23.11.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë. Kurse për rekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2245, datë 02.06.2023, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk parashtronte shkaqe të bazuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

3. Në datën 25.07.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 01.08.2024.

4. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 30.09.2024, ka vendosur kthimin e kërkesës për plotësim të metash, me qëllim paraqitjen nga ana e kërkuesit të provave ose argumenteve lidhur me momentin e marrjes dijeni ose/dhe vënies në dispozicion të tij të vendimit nr. 00-2023-2245, datë 02.06.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si dhe paraqitjen e informacionit në lidhje me qëllimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore. Në datën 23.10.2024 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatë plotësimin e kërkesës.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

5. ***Kërkuesi***, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

5.1. *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

5.1.1. *Së drejtës për t'u njoftuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi Gjykata e Lartë, në shkelje të ligjit procedural dhe material, duke mos njoftuar palët, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit në dhomën e këshillimit.

5.1.2. *Së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë ka paragjykuar shkaqet e rekursit, ndonëse kishte për detyrë të identifikonte se cila ishte mosmarrëveshja objekt gjykimi, si dhe nuk ka korrigjuar mangësitë e gjykatave më të ulëta. Po kështu, kërkuesi nuk ka marrë përgjigje nga gjykatat se mbi cilat parashikime të ligjit kanë bazuar vendimmarrjet e tyre në lidhje me vlerësimin e veprimeve të kundërshtuara.

5.1.3. *Parimit të barazisë së armëve*, pasi gjykatat më të ulëta u kanë dhënë përparësi argumenteve të palës së paditur në gjykim, duke i pranuar ato si të bazuara në ligj dhe në prova.

5.1.4. *Parimit të sigurtisë juridike*, pasi shqyrtimi i çështjes duhet të bëhet në bazë të provave shkresore dhe shkencore. Në rastet kur mosmarrëveshja është shqyrtuar në themel nga gjykatat, ajo duhet të vendoset përfundimisht dhe jo të vendoset në diskutim, sikurse ka ndodhur në rastin e kërkuesit.

- 5.1.5. *Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi procesi gjyqësor ka zgjatur për shumë vite dhe për këtë shkak kërkuesit i është kufizuar e drejta e gëzimit të pronës.
- 5.1.6. *Parimit të ligjshmërisë*, pasi të drejtat dhe interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga një veprim administrativ, përveç rasteve kur parashikohet me ligj dhe duke respektuar procesin e rregullt ligjor.
- 5.2. *Të drejtën e pronës private*, pasi pasuritë e fituara nga kërkuesi me AMTP-të sipas ligjit janë edhe pasuri të trashëguara në emër të babait të tij. Këto pasuri me akte të falsifikuara i ka fituar edhe shtetasi S.J., të cilat në vijim ia ka kaluar djalit të tij A.J.

## II

### Vlerësimi i Kolegjit

#### A. *Për legjitimimin e kërkuesit*

6. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

7. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

8. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ankuesi duhet të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih*

*vendimet nr. 28, datë 18.05.2023; nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 56, datë 25.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese).*

9. Në lidhje me pretendimin për cenimin e standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata në jurisprudencën e saj, në referim të ndryshimeve ligjore të bëra në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, ka vlerësuar se, si rregull, individit duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme në përputhje me parashikimet e këtij kodi dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimin nr. 3, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, nga materialet e çështjes nuk rezulton që kërkuesi t'i ketë shfrytëzuar këto mjete ligjore, por e ka parashtruar këtë pretendim drejtpërdrejt përpara Gjykatës. Prandaj Kolegji vlerëson se ai nuk i ka shteruar mjetet ligjore efektive përpara se të vinte në lëvizje gjykimin kushtetues. Ndërsa në lidhje me pretendimet e tjera, në kushtet kur nuk ka mjet tjetër ankimi kundër vendimit të Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit, Kolegji çmon se kërkuesi i ka shteruar mjetet e ankimit në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.

11. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000, përcakton afatin ligjor 4-mujor për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë nga konstatimi i cenimit. Gjykata ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi gjyqësor i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i kundërshtuar nga kërkuesi, mban datën 02.06.2023, ndërsa sipas informacionit të përcjellë në rrugë elektronike nga Gjykata e Lartë vendimi i saj nr. 00-2023-2245, datë 02.06.2023 është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 22.07.2023, datë nga e cila është bërë i disponueshëm për palët. Duke marrë në konsideratë këtë datë, duke qenë se ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 25.07.2024, ai është dukshëm jashtë afatit ligjor 4-mujor.

13. Kolegji vëren se pas kthimit të kërkesës për plotësim, kërkuesi ka parashtruar se duke mos pasur mundësi të kontaktojë me avokatin e tij dhe duke mos ditur të kërkonte të dhëna në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë për t'u vënë në dijeni për vendimin e marrë për të (duke

pasur parasysh moshën dhe arsimin e tij) i është drejtuar Dhomës së Avokatisë Tiranë për ndihmë juridike. Kjo e fundit e ka informuar në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë dhe më pas e ka orientuar të paraqesë kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për ndihmë juridike dytësore. Ndërkohë nga materialet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, si dhe nga ato të vëna në dispozicion në vijim nga kërkuesi, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj gjykate me kërkesë për ndihmë juridike dytësore për të kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, e cila është pranuar me vendimin nr. 564 regj. themeltar, datë 07.06.2024.

14. Bazuar në rrethanat konkrete të çështjes, duke mbajtur në konsideratë faktin se kërkuesi është pensionist dhe ka shfaqur interesin e tij për të kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, duke iu drejtuar fillimisht dhomës së avokatëve dhe më pas gjykatës për ndihmë juridike dytësore, Kolegji vlerëson se për kërkuesin data e marrjes dijeni do të konsiderohet data 07.06.2024 e vendimit për pranimin e kërkesës për dhënien e ndihmës juridike dytësore. Në këto kushte, Kolegji çmon se ai legjitimohet edhe *ratione temporis*.

15. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor të iniciuar prej tij për shfuqizimin e vendimit nr.197, datë 29.01.2016 të KVVTP-së pranë Prefektit të Qarkut Elbasan, duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në drejtim të së drejtës për t'u njoftuar, së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit, parimeve të barazisë së armëve, sigurisë juridike dhe ligjshmërisë, si dhe së drejtës së pronës.

16. Për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, kërkuesi ka pretenduar se shqyrtimi i çështjes duhej të bëhej në bazë të provave shkresore dhe shkencore. Në rastet kur mosmarrëveshja është shqyrtuar në themel nga gjykatat, ajo duhet të vendoset përfundimisht dhe jo të vendoset në diskutim, sikurse ka ndodhur në rastin e kërkuesit. Po kështu kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e parimit të ligjshmërisë, pasi të drejtat dhe interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga një veprim administrativ, përveç rasteve kur parashikohet me ligj dhe duke respektuar procesin e rregullt ligjor.

17. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese. Çështjet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, mund të merren në konsideratë në gjykimin kushtetues vetëm nëse cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave të juridiksionit të

zakonshëm (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, referuar argumenteve të sjella nga kërkuesi, Kolegji vlerëson se në thelb ato janë të përgjithshme dhe kanë të bëjnë me çështje të interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme, të cilat dalin jashtë juridiksionit kushtetues, ndaj nuk mund të merren në shqyrtim.

18. Për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të barazisë së armëve, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat më të ulëta u kanë dhënë përparësi argumenteve të palës së paditur në gjykim, duke i pranuar ato si të bazuara në ligj dhe në prova. Nisur nga thelbi i këtij argumenti, ai do të analizohet në vijim në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit.

19. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, duke mbajtur në konsideratë se argumentet e kërkuesit lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj tij, çështja do të analizohet në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

20. Për sa më lart, në vijim Kolegji vlerëson të analizojë pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues.

#### *B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u njoftuar dhe për t'u mbrojtur*

21. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë në shkelje të ligjit procedural dhe material, nuk e ka njoftuar për datën e shqyrtimit të çështjes, duke vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit të tij.

22. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për t'u njoftuar për gjykimin dhe pjesëmarrja në të janë të lidhura me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Sipas Gjykatës, kjo e drejtë u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nga kërkuesi nëpërmjet rekursit, i cili është regjistruar në datën 12.01.2023. Nga përmbajtja e materialeve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual nuk rezulton që ai të ketë deklaruar ose të ketë bërë të njohur për gjykatën një adresë të postës elektronike (*e-mail*) për qëllime të marrjes së njoftimeve edhe në rrugë elektronike, sipas urdhrit nr. 131, datë 02.07.2021 të Gjykatës së Lartë “Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve”. Ndërkohë, sipas faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, kjo e fundit në datën 08.05.2023 ka publikuar çështjet që do të shqyrtoheshin në dhomën e këshillimit në datën 02.06.2023, ku përfshihej edhe çështja e kërkuesit. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të rekursit, ajo gjykatë ka vlerësuar se ai nuk plotësonte kriteret e pranueshmërisë, duke vendosur për këtë shkak mospranimin e tij.

24. Nga sa më lart, nisur nga fakti se rekursi është paraqitur nga vetë kërkuesi, i cili ka detyrimin të ndjekë fatin e çështjes së tij dhe se njoftimi i shqyrtimit të rekursit është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, Kolegji çmon se argumentet e tij nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u njoftuar. Kolegji çmon se vetëm fakti që rekursi është shqyrtuar në dhomën e këshillimit nuk është i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt, për sa kohë që Kolegji Administrativ ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij dhe me rregullat procedurale që gjejnë zbatim gjatë kësaj faze të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë.

25. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u njoftuar dhe të drejtës për t’u mbrojtur është haptazi i pabazuar.

### *C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit*

26. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat më të ulëta u kanë dhënë përparësi argumenteve të palës së paditur në gjykim, duke i pranuar ato si të bazuara në ligj dhe në prova. Gjykata e Lartë ka paragjykuar shkaqet e rekursit, ndonëse kishte për detyrë të identifikonte se cila ishte mosmarrëveshja objekt gjykimi, si dhe nuk ka korrigjuar mangësitë e gjykatave më të ulëta. Po kështu, kërkuesi nuk ka marrë përgjigje nga gjykatat se mbi cilat parashikime të ligjit kanë bazuar vendimmarrjet e tyre në lidhje me vlerësimin e veprimeve të kundërshtuara.

27. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm



të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjithashtu, sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në rastin konkret Kolegji vëren se kërkuesi duke pretenduar se për tokën bujqësore në pronësi të tij është regjistruar në mënyrë të paligjshme një AMTP në emër të një shtetasi tjetër, ka kundërshtuar vendimin nr.197, datë 29.01.2016 të KVVTP-së pranë Prefektit të Qarkut Elbasan, me të cilin është vendosur pavlefshmëria e kësaj AMTP-je dhe kalimi i pasurisë në pronësi të shtetit. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e këtij vendimi dhe kalimin e pasurive në pronësi të tij. Prandaj nën dritën e standardeve të mësipërme, Kolegji do të vlerësojë nëse në rastin konkret gjykatat më të ulëta dhe, në vijim, Gjykata e Lartë i kanë marrë në shqyrtim pretendimet e tij dhe nëse u ka kthyer atyre përgjigje.

30. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, si të pambështetur në prova dhe në ligj. Kjo gjykatë ka arsyetuar se, bazuar në ligjin nr. 7501/1991 "Për tokën" dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, është parashikuar shprehimisht se kur AMTP-ja e përfituesit të tokës bujqësore shfuqizohet me vendim të gjykatës, prona e përfituar padrejtësisht duhet të kalojë në pronësi të shtetit dhe jo të mbetet në pronësi të personave të tretë. Kërkuesi nuk mund të legjitimohet dhe nuk mund të realizojë të drejtën e tij të cenuar me anë të një procedure administrative ose duke ngritur padi për shfuqizimin e vendimit të marrë nga organi administrativ. Gjykata, gjithashtu, është shprehur se vendimi i këtij organi nuk

mund të sjellë pasoja juridike pa u paraqitur në gjykatë padia përkatëse për shfuqizimin e AMTP-së nga Prefekti i Qarkut sipas ligjit nr. 9948/2008. Për rrjedhojë, kërkuessit i lind e drejta të ndërhyjë në gjykimin e nisur nga ana e Prefektit të Qarkut Elbasan për shpalljen e pavlefshmërisë së AMTP-së ose t'i drejtohet gjykatës me padi për rivendikimin e sendit. Në përfundim, sipas gjykatës, kërkuessi nuk ka depozituar akte të cilat të provonin cenimin atij të interesave të ligjshëm nga vendimi i kundërshtuar i KVVTP-së pranë Prefektit të Qarkut Elbasan.

31. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 553, datë 23.11.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë me argumentin se ai nuk reflekton shkelje as në procedurën e zhvillimit të gjykimit, as në procedurën e marrjes së vendimit. Kurse Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se rekursi nuk parashtronte shkaqe të bazuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 dhe se i takonte kërkuessit të parashtronte në mënyrë të plotë shkaqet ligjore, duke argumentuar përse është zbatuar në mënyrë të gabuar ligji material apo procedural dhe përse shkalla e shkeljes është e një rëndësie themelore për njehsimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, si dhe cilat janë ato shkelje të rënda procedurale që ndikojnë dukshëm në dhënien e vendimit.

32. Nisur nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, Kolegji çmon se ato kanë analizuar pretendimet e kërkuessit duke i kthyer përgjigje se ai nuk legjitimohet në lidhje me kërkimin për kundërshtimin e vendimit të KVVTP-së pranë Prefektit të Qarkut Elbasan dhe kalimin e pronës në pronësi të tij, ndërsa për cenimin e pretenduar të së drejtës së pronës gëzonte të drejtën t'i drejtohej gjykatës me padinë e rivendikimit të sendit. Edhe për sa i përket vendimit të mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, ai tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në recurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimin të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, Kolegji Administrativ tregon se pasi i ka vlerësuar ato ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuessi është haptazi i pabazuar. Po kështu, duke pasur parasysh edhe natyrën e gjykimit në atë gjykatë, arsyetimi i kufizuar i vendimit nuk cenon në vetvete standardet kushtetuese, duke qenë tashmë një formë e konsoliduar në praktikën e saj. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

33. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.